



2023 - 2024

STOMATOLOGJI - Master i Integruar

Programi i integruar i ciklit të dytë të studimit në Stomatologji synon pajisjen e studentëve me njohuri mbi konceptet teorike bazë dhe të thelluara e aftësi praktike për ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe në përputhje me kërkesat e direktivës së komunitetit europian 78/687 CEE 1 për ushtrimin e profesionit të stomatologut. Programi është i hartuar dhe organizuar bazuar në disiplinave formuese duke bërë integrimin e njohurive teorike shkencore që përftohen nga shkencat e formimit bazë të stomatologut, me njohuritë fispatologjike e klinike të mjekësisë së përgjithshme, dhe rritjen e njohurive dhe aftësive profesionale, me qëllim njohjen dhe vlerësimin në mënyrë kritike nga pikëpamja klinike por edhe social – kulturore të dhënat e gjendjes së shëndetit dhe sëmundjes së aparatit stomatik të individit.

Programi i studimeve në Stomatologji përfshin veç njohurive të formimit të përgjithshëm edhe njohuritë në lëndët profesionale si higjienë dentare, terapitë, profilaksitë në pjesën e parandalimit të sëmundjeve dentare, dhe lëndë që aftësojnë profesionistin në menaxhimin etik dhe njerëzor të problemeve të pacientit.

Kohëzgjatja & Forma e studimit

- ✓ Studime me kohë të plotë
- ✓ Kohëzgjatja e studimeve në program 5 vite akademike

Në përfundim të programit mësimit student aftësohet të:

1. Studentët do të jenë të aftë të punojnë në profilaksi dhe higjenë dentare, terapi edodontike, terapi rikonstruktive, ortodonci fikse dhe e lëvizshme, kirurgji orale dhe implantologji, kirurgji oro-maksilofaciale;
2. Do të kenë aftësitë dhe kompetencat të specializohen në të gjitha nëndisiplinat e stomatologjisë në specializime afatgjata.
3. Do të zhvillojnë një sërë aftësish teknike e profesionale në lidhje me komunikimin me pacientin, shëndetin publik, etikën në deontologji, metodat e kërkimit shkencor etj.
4. Nëpërmjet orëve të dedikuara praktike do të aftësohen praktikisht në trajtimin e pacientit, dhe menaxhimin e situatave rast pas rasti.

Adresa:

Kampusi 1, Rruga eKosovarëve, (pranë digës së Liqenit Artificial) Cel: +355 69 20 62 086 | +355 69 20 41 222

E-mail: info@umb.edu.al | admissions@umb.edu.al | Web: www.umb.edu.al

Kampusi 2, RrugaFrang Bardhi, Selitë | Cel: +355 69 20 67 247 | E-mail: mastersecretary@umb.edu.al | Web: www.umb.edu.al

Mundësi Punësimi

- ✓ Ofruesit e shërbimeve shëndetësore parësore publike dhe jopublike
- ✓ Ofruesit e shërbimeve spitalore
- ✓ Institucione arsimore
- ✓ Klinika stomatologjike private
- ✓ Depo dentare
- ✓ Kompani importuese te materialeve dentare
- ✓ Organizata të ndryshme jofitimprurëse

Kurrikula

- Anatomi dhe morfologji dentare
- Njohuri materiale dentare
- Dentistri preventive dhe terapi paraklinike
- Protetike I,II,III
- Lazeri dhe dentistria digjitale
- Radiologji dhe Diagnoza orale
- Edodonti I,II,III
- Dentistri konservative I,II,III
- Anestezi dhe Framakologji orale
- Peridontologji I
- Dentistri pediatrike I
- Ortodonci I,II,III
- Kirurgji oro-maxilo-faciale I,II
- Implantologji

